

VENDIM
Nr. 960, datë 2.12.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 527, DATË 27.9.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, MARRJEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM DHE VENDOSJEN E SERVITUTIT TË PËRHERSHËM TË
KALIMIT, PËR INTERES PUBLIK, MBI DISA PASURI TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA KORRIDORI I PUNËS (RRUGËT HYRËSE)
DHE SISTEMI I GAZSJELLËSIT (MIKROTUNELI), PJESË E PROJEKTIT TRANS
ADRIATIK PIPELINE (PROJEKTI TAP) AG”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 7 e 8, pjesa e parë dhe e dytë, të shtojcës 1, të marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG”, si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 527, datë 27.9.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 3 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 29 112 048.47 (njëzet e nëntë milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë e dyzet e tetë pikë dyzet e shtatë) lekësh, për sipërfaqet, si më poshtë vijon:

- 29 (njëzet e nëntë) m², që shpronësohet;
- 7 433 (shtatë mijë e katërqind e tridhjetë e tre) m², që merret në përdorim të përkohshëm;
- 1 478 (një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) m², mbi të cilën vendoset servituti.

5. Vlera e përgjithshme prej 29 112 048.47 (njëzet e nëntë milionë e njëqind e dymbëdhjetë mijë e dyzet e tetë pikë dyzet e shtatë) lekësh dhe të gjitha shpenzimet e tjera procedurale përfshirë edhe ato shtesë prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohen nga shoqëria TAP AG, si subjekt kërkues.”.

b) Të dhënat për numrat rendorë 1, 5, 6, 9 dhe 11, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria TAP AG, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përkatësisht, Korçë, Devoll, Berat, Skrapar e Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PASURIVE TË CILAT PREKEN NGA KORRIDORI I PUNËS (RRUGËT HYRËSE) DHE SISTEMI I GAZSJELLËSIT (MIKROTUNELI), RRETHET: KORÇË, DEVOIL, BERAT DHE SKRAPAR

Nr. në VKM nr. 527, datë 27.9.2017	Pronari/përdoruesi			ZK	Nr. pas.	Lloji i pas.	Sip. m ² Përdorim të përkohshëm 2 vjet	Çmi- mi/ m ²	Vlera, lekë	Sip. m ² Servitut	Çmim/ m ²	Vlera, lek	Sip. m ² shpronësimit	Çmimi/m ²	Vlera, lek	Vlera totale e kulturave	Objekte, vlera lekë	Vlera totale, lek	Indeksi i hartës	Shënime
1	Petrit	Reshat	Xhizdari	2739	207	Kullot ë				341	101	34,325.74				17,425.00		51,750.74	K-34- 125- (135-B)	ZVRPP-ja konfirmon se pasuria ka kufizim.
	Muharrem	Reshat	Xhizdari																	
	Beqir	Reshat	Xhizdari																	
	Ferdinant	Reshat	Xhizdari																	
	Lavdiqe	Reshat	Xhizdari																	
	Drita	Reshat	Xhizdari																	
	Tomorr	Hajri	Shurdhi																	
	Leonora	Hajri	Muabelliu																	
	Albana	Hajri	Shurdhi																	
5	Maria	Rushan	Sulka	2739	130/5	Arë	92	69.8	6,417.00	69	140	9,625.50						16,042.50	K-34- 125- (119-C)	ZVRP-ja konfirmon se pasuria ka kufizim
	Faik		Sulka													164,230.40		164,230.40		Përdoruesi likudohet vetëm për kulturat.
6	Maria	Rushan	Sulka	2739	130/6	Arë	142	69.8	9,904.50	93	140	12,973.50						22,878.00	K-34- 125- (119-C)	ZVRPP-ja konfirmon se pasuria ka kufizim.
	Feti		Sulka													87,380.52		87,380.52		Përdoruesi likudohet vetëm për kulturat.
9	Pellumb	Sheme	Sulka	2739	130/4	Arë	355	69.8	24,761.25	274	140	38,223.00						62,984.25	K-34- 125- (119-C)	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Dajlan	Rahman	Seitaj	1420	1/19	Trrall	775	175	135,625.00	367	630	231,210.00				9,300.00	16,208,116.64	16,584,251.64	CO-H-2	ZVRPP-ja konfirmon se mbi pasurinë është vendosur sekuetro konserervative dhe kufizim.
	Ardian	Shaqir	Caka																	